



## **Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”**

# **FAKULTETI EKONOMIK PLANI STRATEGJIK 2019-2021**

**Mitrovicë**

## **PËRMBAJTJA**

<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>4</b>
<b>FJALA E DEKANIT .....</b>	<b>6</b>
<b>HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK .....</b>	<b>7</b>
<b>VESHTRIM MBI HISTORIKUN E FAKULTETIT EKONOMIK .....</b>	<b>8</b>
<b>VIZIONI .....</b>	<b>10</b>
<b>MISIONI .....</b>	<b>10</b>
<b>VLERAT E FAKULTETIT EKONOMIK .....</b>	<b>11</b>
<b>PALËT E INTERESIT .....</b>	<b>12</b>
<b>PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK .....</b>	<b>14</b>
<b>OBJEKTIVAT STRATEGJIKE .....</b>	<b>12</b>
<b>PLANI I VEPRIMIT 2019 -2021 .....</b>	<b>13</b>
<b>MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI .....</b>	<b>23</b>
<b>PERFUNDIMI.....</b>	<b>24</b>

## SHKURTESAT

AKA	Agjencia Kosovare e Akreditimit
GE	Grupi i ekspertëve
FE	Fakulteti Ekonomik
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
IMGC	International Multidisciplinary Geo-Science Conference
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KD	Këshilli Drejtues
MF	Ministria e Financave
KP	Komisioni profesional
KQSCV	Komisioni qëndror për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
PA	Parlamenti Studentor
PSUMIB	Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”
PSFE	Plani Strategjik i Fakultetit Ekonomik
RN	Rezultate të të nxënit
SA	Stafi akademik
SI	Sistemi informativ
TI	Teknologjia informative
UP	Universiteti i Prishtinës
ECTS	Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve
THV	Të hyrat vetanake
UMIB	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
ZBN	Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar
ZÇA	Zyra për çeshtje akademike
ZIKP	Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun
ZP	Zyra e personelit
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë
ZSHS	Zyra për shërbime të studentëve

## **DOKUMENTET E KONSULTUARA**

- Plani Strategjik i Rishikuar të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për periudhën kohore 2019-2021
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 të Qeverisë së Kosovës;
- Ligji për Arsimin e Lartë i Republikës së Kosovës, 2010;
- Plani Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021;
- Statuti i përkohshëm i UMIB-it.
- Korniza Kombëtare të Kualifikimeve 2011

## FJALA E DEKANIT

Fakulteti Ekonomik, në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, përfaqëson një nga alternativat më serioze, profesionale si dhe me konkurente në tregun e Arsimit të lartë në Kosovë, në fushën e biznesit dhe menaxhimit, duke ofruar standarde dhe cilësi në mësimdhënie dhe hulumtim, konform kërkesave të tregut vendor të punës, rajonal e më gjërë, i integruar plotësisht në hapësirën rajonale si dhe evropiane të arsimit të lartë. Fakulteti është i orientuar drejt vlerave dhe formave bashkohore të hulumtimit dhe zhvillimit, dhe synon që të nxjerrë specialistë të fushave të ndryshme: menaxher, ndërmarrës, financier, kontabilist, bankier, menaxher në fushat e industrisë... të cilët do të jenë kompetentë që t’u përgjigjen sfidave bashkëkohore në biznes dhe menaxhim, por edhe mënyrës së të jetuarit dhe vepruarit në një shoqëri të hapur.

Për një fakultet të ri, siç është Fakulteti Ekonomik, i cili operon në kuadër të UMIB-it, përcaktimi i qartë i prioriteteve strategjike, si dhe masave të cilat duhet ndërmarrë për realizimin e tyre, është çështje me rëndësi vitale për të ardhmen e tij.

Andaj, ky dokument paraqet një përmbledhje të procesit të planifikimit strategjik të zhvilluar në kuadër të Fakultetit dhe që të jetë sa më gjithëpërfshirës, në hartimin e tij kanë qenë të përfshirë shumë akterë: stafi akademik, stafi administrativ, menaxhmenti, studentët, alumni, komuniteti biznesor. Përpilimi i këtij dokumenti me rëndësi, u mundësua falë një bashkëpunimi të singert me të gjithë akterët e cekur më sipër, të cilët ndikuan në ngritjen e cilësisë së tij. Pra, është një dokument gjithëpërfshirës, i hapur, por edhe i ndryshueshëm. Kështu, si i tillë nuk është shtrues, por lë mundësi për përmirësim dhe përditësim në të ardhmen, gjithnjë me përfshirjen e paleve të interesit. Në këtë rast dëshiroj të falënderoj ekipin që hartoi Planin Strategjik, por edhe tërë stafin akademik të FE, të cilët me vërejtjet dhe sygjërimet e tyre ndikuan në ngritjen e cilësisë së këtij dokumenti me rëndësi.

Prof. Asoc. Dr. Qazim TMAVA

Dekan i Fakultetit Ekonomik

## **HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK**

Plani strategjik i Fakultetit Ekonomik (PSFE), i hartuar për periudhën kohore 2019-2021, është hartuar si pjesë integrale e Planit Strategjik të rishikuar të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (2019-2021), si dhe Statutin e Përkohshëm të Universitetit “Isa BOLETINI” në Mitrovicë.

Arsyet e nxjerrjes së një akti të tillë, me rëndësi vitale për Fakultetin Ekonomik, janë të natyrës interne dhe eksterne. Arsyet interne, i gjejmë tek nevoja e posedimit të një dokumenti strategjik zhvillimor, i cili do të na shërben si bazë për krijimin e programeve dhe planeve zhvillimore vjetore, të cilat do të harmonizohen me qëllimet afatgjata zhvillimore të Fakultetit Ekonomik. Në këtë mënyrë, Fakulteti Ekonomik planet konkrete zhvillimore por edhe pritet nga ato, i bënë të qasshme para të gjitha palëve të interesit. Andaj, është i hapur për çdo vërejtje, sugjerim, apo rekomandim konkret, me qëllim të avansimit të këtij plani strategjik. Ndërsa, arsyet eksterne të nxjerrjes së këtij plani, burojnë nga ligjet dhe dokumentet strategjike, të nxjerra në nivel vendi dhe më gjërë, të cilat kanë të bëjë me Institucionet e arsimit të lartë, të cilat i specifikojmë në vijim: Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, Ligjin 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Standardet Udhëzuesit të Akreditimit të Agjensionit Kosovar të Akreditimit (AKA) dhe Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve (GE) me rastin e vizitës gjatë akreditimit të njësisë akademike. Për hartimin e këtij Planit strategjik, është formuar komisioni i caktuar, në kuadër të njësisë, i përbërë nga mesimdhënësit, menaxhmenti, përfaqësuesit e studentëve, alumni, si dhe përfaqësuesi nga bizneset, të cilët i falenderojmë për kontributin e dhënë.

## **GRUPI PUNUES**

Anëtarët të cilët huartuan Planin Strategjik të Fakultetit Ekonomik, të emruar në Këshillin e Fakultetit Ekonomik, i prezantojmë në vijim:

1. Prof. Asoc. Qazim Tmava (kryesues)
2. Prof. Ass. Dr. Bashkim Bellaqa (anëtar)
3. Prof. Ass. Dr. Esat Durguti (anëtar)
4. Ph.Dc. Filloreta Kunoviku Demiri (anëtar)

5. MSc. Milaim Mehmeti (anëtar)
6. PhDs. Besë Sadikaj (anëtar)
7. Allmir Krasniqi(anëtar),
8. Blerta Hajra (anëtar),
9. Xhevat Bekteshi (anëtar),

## **VËSHTRIM MBI HISTORIKUN E FAKULTETIT EKONOMIK**

Themelet e studimeve të arsimit të lartë në Mitrovicë u vunë me hapjen e Shkollës së Lartë Teknike në vitin 1961. Në vitin 1970 në kuadër të Fakultetit Teknik hapen degët e Xehetarisë, Teknologjisë dhe Metalurgjisë, fillimisht në Mitrovicë, viti shkollor 1970/71, për të vazhduar pastaj në Prishtinë deri në themelimin e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë në vitin 1974. Duke u bazuar në traditën mbi 60 vjeçare të arsimit të lartë në Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 06.03.2013 ka themeluar Universitetin Publik të Mitrovicës, kurse Kuvendi i Kosovës me datën 31 maj 2013 ka ratifikuar vendimin. Në bazë të Statutit të Përkohshëm, i miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”(UMIB) funksionojnë gjashtë fakultete: Fakulteti i Gjeoshkencave (FGJ), Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore (FTU), Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK), Fakulteti Juridik (FJ), Fakulteti Ekonomik (FE) dhe Fakulteti i Edukimit (FE).

Në kuadër të këtyre fakulteteve, numri total i programeve të akredituara në UMIB deri në shtator të vitit 2019 është 20 programe në kuadër të dy niveleve: Bachelor dhe Master. Në procesin mësimor në UMIB janë të angazhuar gjithsej 114 mësimdhënës dhe asistentë. Prej tyre në marrëdhënie të rregullt pune janë 98 mësimdhënës: 20 profesorë të rregullt, 22 profesorë të asocuar, 24 profesorë asistentë, dhe 32 asistentë.

Fakulteti Ekonomik, në kuadër të UMIB ka filluar punën në vitin akademik 2013-2014 në dy drejtime: Banka, Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment dhe Informatike si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës (UP) në Prishtinë, ndërsa nga viti akademik 2015-2016, ka vazhduar në kuadër të UMIB-it, në Mitrovicë.

Fakulteti Ekonomik, për vitin akademik 2015-2016 shpalli konkursin për studentë të rregullt në dy drejtime: Banka, Financa dhe Kontabilitet si dhe në Menaxhment dhe Informatikë, për 220 vende ku 200 vende ishin për studentë nga Kosova, 10 vende për komunitetet si: boshnjak, turk, romë,

ashkali dhe egjiptian, si dhe 10 vende për: Preshevë, Bujanoc, Mal të Zi, Shqipëri dhe Maqedoni. Nga viti akademik 2015-2016 në Fakultetin Ekonomik organizohen studimet sipas plan programeve të miratuara nga Senati i UMIB-it, të mbështetura në Deklaratën e Bolonjës, sa i përket vendosjes së një sistemi krediti siç është Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve (ECTS) si një mjet për të promovuar lëvizjen e studentëve si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Në vitin akademik 2015-2016 AKA, ka akredituar studimet Bachelor të Fakultetit Ekonomik, me dy departamente: Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe Menaxhment dhe Informatikë.

Në vitin akademik 2018-2019, është akredituar programi Biznes dhe Menaxhment në nivelin Bachelor me specializimin Banka, Financa dhe Kontabilitet. Duke u nisur nga nevoja e domosdoshme për organizimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas standardeve dhe kriterëve të Universiteteve Evropiane dhe më gjerë, Fakulteti Ekonomik në kuadër të UMIB-it propozon modelin e studimeve të reformuara sipas planeve dhe programeve të mbështetura në rekomandimet e Deklaratës së Bolonjës.

## **VIZIONI**

Vizioni i Fakultetit Ekonomik është që të jetë Institucion prijës i Arsimit të Lartë në Kosovë dhe rajon, në edukim dhe hulumtim shkencor, për përgatitjen e kadrove në fusha unike në mënyrë që të plotësojnë nevojat sipas trendeve zhvillimore të ekonomisë.

## **MISIONI**

Misioni i FE është zhvillimi i arsimit efektiv që kontribuon në ngritjen e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies shoqërore në nivel vendi përmes ofrimit të një arsimit dhe kërkimi shkencor të një cilësie të lartë, përmes aplikimit të praktikave moderne si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë.

Fakulteti Ekonomik përmes rishikimit dhe zgjerimit të programeve arsimore, kërkimore si dhe ndërmarrëse të arrijë nivelet më të larta të arsimit të lartë në regjion përmes përgatitjes së menaxherëve, ndërmarrësve, inovatorëve, ekonomistëve, kontabilistëve, financierëve kompetent për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës.



## VLERAT E FAKULTETIT EKONOMIK

Vlerat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Fakultetit Ekonomik janë të lidhura ngushtë me vlerat e UMIB-it, të cilat janë:

- Studime cilësore
- Respekti dhe pergjegjesia
- Drejtësi dhe ndershmëri
- Transparence dhe integritet
- Diversitet dhe mirëqenie
- Kreativitet dhe liri intelektuale
- Kujdesi ndaj mjedisit dhe shoqërisë.
- Etika.

## PALËT E INTERESIT

Zhvillimi strategjik i Fakultetit Ekonomik, për periudhën 2019 - 2021, është me interes madhor për shumë palë të interesit, andaj është hartuar dhe planifikohet të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë dhe me koordinim të gjërë, me të gjithë. Palët e interesit përfshijnë një spektër të gjërë akterësh: stafin akademik, studentët, menaxhmentin, stafin administrativ e teknik, alumnin, komunitetin biznesor, autoritetet shtetërore (të nivelit lokal e qendror) si dhe komunitetin e jashtëm akademik e shkencor. Nisur nga fakti se burimet njerëzore paraqesin pasurinë më të rëndësishme të çdo institucioni të arsimit të lartë, në çdo vend, andaj stafi akademik, stafi administrativ e teknik si dhe Menaxhmenti i njesisë janë listuar më së larti në grupin e palëve të interesit.

**Stafi akademik** i njesisë akademike- përbëjnë bartësit kryesor të procesit mësimor efektiv, këshillimit akademik dhe këshillimit të studentëve. Stafi është përgjegjës për zhvillimin e vazhdueshëm të kurrikulës përmes vlerësimit, veprimtarisë studimore, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë grup interesi përfshihen profesorët me kontratë të rregullt pune, profesorët e angazhuar, asistentët, por dhe bashkëpunëtorët shkencor. Stafi akademik, varësisht nga thirrja akademike, kanë këtë përbërje: Prof. Dr., Prof. Asoc. Dr., Prof. Ass. Dr., Ass. dhe Ligjërues.

**Personeli administrativ dhe teknik** – përbëjnë gjithashtu palë të brendshme të interesit shumë me rëndësi, të cilët kryejnë funksionet operacionale dhe administrative të Fakultetit Ekonomik, administrimin e fakultetit dhe pjesëve përberëse të tij, marrëdhëniet me publikun, sidhe shërbimet studentore. Në këtë grup interesi përfshihen: sekretari i njësisë akademike, zyrtarët e administratës, bibliotekistët dhe personeli teknik.

**Menaxhmenti i njësise akademike** - Menaxhmenti i Fakultetit Ekonomik, përbën organin udhëheqës dhe vendim-marrës që përkujdesen për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës edukative-kërkimore, sigurimit të cilësisë, bashkëpunimit ndërkombëtar të njësisë etj. Në kuadër të menaxhmentit përfshihen: Këshilli i Fakultetit, Dekani, Prodekani, Shefi i departamentit dhe koordinatori i cilësisë.

**Studentët** - Studentët paraqesin palën më qenësore të interesit për zhvillimin e Fakultetit Ekonomik. Andaj, informacioni që mirret nga studentët në formë të vlerësimeve dhe sygjërimeve, paraqesin forcat shtytëse drejt suksesit të njësisë akademike. Studentet, si pala kyçe e interesit, janë nga shumica e trevave kosovare, por edhe me gjërë.

**Alumni** – si një palë interesi me rëndësi, paraqesin organizimin grupor të studentëve të diplomuar, dhe të cilët trajtohen si njëpasuri e një rëndësie të veçantë. Në kuadër të Universitetit, ku bëjnë pjesë aktive edhe studentet e diplomuar të Fakultetit Ekonomik, është themeluar Shoqata Alumni, e cila shërben si urë lidhëse në mes studentëve aktual, personelit akademik dhe administrativ, ish studentëve, si dhe komunitetit. Fakulteti në vazhdimësi ofron shërbime ndaj këtij grupi të interesit, si dhe i mban të informuar dhe të interesuar për zhvillimin e vazhdueshëm, dhe mundësive për bashkëpunim.

**Komuniteti i biznesit** – është palë strategjike dhe përbëhet nga akterë të ndryshëm të cilët janë me interes madhor si për strukturën e biznesit ashtu edhe për studentët. Ky komunitet përbehet nga përfaqësuesit e bizneseve, bizneset lokale por edhe më gjërë, përfaqësuesit e industrisë, shoqatave dhe organizatave biznesore. Së shpejti, do të formohet edhe Bordi Industrial në kuadër të Fakultetit.

**Autoritetet qeveritare (lokale e qëndrore)** – ky grup me rëndësi përfshinë përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale të rajonit të Mitrovicës, Vushtrrisë, Skenderajit, (MASHT), Ministria e Financave (MF), Ministria e Administratës Publike (MAP), etj.

**Komuniteti i jashtëm akademik dhe shkencor** - përbëhet nga partnerët e jashtëm strategjik të Fakultetit Ekonomik, si dhe Universitetit. Në këtë grup përfshihen universitetet dhe fakultetet bashkëpunuese në Kosovë dhe jashtë, Institutet kërkimore-shkencore, shkollat e mesme (si një fidanishte për studentët e ardhshëm), si dhe Institucionet tjera të cilat e ndihmojnë Fakultetin Ekonomik në ngritjen dhe avansimin e kapaciteteve akademike, hulumtuese dhe shkencore.

### Analiza SWOT e FE

<b>Pikat e forta</b>	<b>Dobësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Misioni i FE në kuadër të UMIB-it, Universitetit Isa Boletini, është qartë i definuar dhe i orientuar nga profilizimi i studimeve në fushën e Biznesit dhe Menaxhmentit;</li> <li>▪ Specializimet në kuadër të programit janë konform me kerkesat e tregut të punës dhe unike;</li> <li>▪ Staf i kualifikuar me përvojë nga fusha të ndryshme ekonomike dhe biznesi;</li> <li>▪ Plani strategjik 2019-2021</li> <li>▪ Mësimdhënia bazohet në konceptet e definuara qartë didaktike dhe hulumtuese;</li> <li>▪ Ofrimi i njohurive bashkëkohore dhe interaktive në përgatitjen e studentëve në fushat e biznesit dhe menaxhmentit krahas kerkesave të tregut;</li> <li>▪ FEnë programin e ofruar studimor ka bërë diferencimin nga Universitetet tjera, gjithnjë, bazuar në programet që Institucionet tjera të Arsimit të Lartë (IAL) ofrojnë;</li> <li>▪ Posedimi i rregulloreve në kuadër të institucionit për funksionim konkret të njësisë;</li> <li>▪ Rregullorja e studimeve bachelor dhe master.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mundësia e kufizuar për praktikën profesionale me pagesë për studentët në institucionet e ndryshme;</li> <li>▪ Literatura e pamjaftueshme sipas kurikulave të reja në gjuhën shqipe;</li> <li>▪ Mungesa e akreditimit të nivelit Master vitin e kaluar e ka zbehur imazhin e fakultetit;</li> <li>▪ Struktura operationale / burokracia.</li> </ul>
<b>Mundësitë</b>	<b>Sfidat (Rreziqet)</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mundësitë e reja për bashkëpunim me industrinë dhe institucionet shtetërore në aspekt të avancimit të bashkëpunimit përmes punëtorive, seminareve, praktikës profesionale, etj.;</li> <li>▪ Interesimi për zgjerimin e programeve të reja;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Buxheti i limituar nga MASHT-i;</li> <li>▪ Zhvillimi i programeve të ngjashme studimore në rajon në të ardhmen;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ritja e kerkesës për avancimin e karrierës dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përceptimi shoqëror dhe studentor i arsimit vetëm si një mjet për të gjetur një vend pune.</li> </ul>
--	--

## PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Planifikimi strategjik është një proces përmes të cilit identifikohen objektivat konkrete si dhe hapat të cilët duhet ndërmarrë që të përmbushet me sukses.

### OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Përmes planit strategjik identifikohen objektivat strategjike të zhvillimit të FE, për periudhën afatmesme të zhvillimit 2019-2021, të cilat i specifikojmë në vijim:

1. Avancimi i aktiviteteve studimore në aspektin e mësimdhënies, ngritjes profesionale dhe mbështetjes së studentëve,
2. Avansimi i hulumtimit dhe zhvillimit shkencor,
3. Ndërtimi i sistemit të sigurimit të cilësisë,
4. Zhvillimi i burimeve njerzore, digjitalizimi dhe informimi publik,
5. Bashkëpunimi ndër-institucional e ndërkombëtar.

Objektivat strategjike të lartëcekur zërthehen në objektiva specifike dhe aktivitete konkrete të cilat duhet ndërmarrë, në mënyrë që të realizohet me sukses. Në PSFE përfshihen edhe bartësit e aktiviteteve, afatet kohore, por edhe resurset e nevojshme për realizimin e këtyre objektivave. Gjithashtu, me qëllim të lehtësimit, të zbatimit me efikasitet, si dhe monitorimit të planit strategjik, plani operacional përmban edhe treguesit kryesor të performancës si dhe rezultatet e pritura, të cilat i lehtësojnë bartësve të aktiviteteve, si dhe grupit monitorues matjen e performancës të secilit aktivitet, objektivë specifike dhe strategjike.

## PLANI I VEPRIMIT 2019 -2021

### Objektivi strategjik: 1. Avancimi i aktiviteteve studimore në aspektin e mësimdhënies, ngritjes profesionale dhe mbështetjes së studentëve

#### Objektiva specifike 1.1. Përmirësimi i metodave të mësimdhënies

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kosto financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.1.1 Ndjekja e trajnimit për metodologjite e reja të mesimdhënies	PMÇSZHC, Zyra për buxhet dhe financa, FE	500,00 €	Numri i stafit të trajnuar	2020	Certifikimi i stafit të FE 100%
1.1.2 Trajnim i avancuar për metodologjite e mësimdhënies.	PMÇSZHC Zyra për buxhet dhe financa, FE	500,00 €	Numri i stafit të trajnuar	2021	Certifikimi i stafit të FE 100%
1.1.3 Trajnim për shqyrtimin e syllabuseve	PMÇSZHC Zyra për buxhet dhe financa, FE	100.00 €	Numri i stafit të trajnuar	2020	90% e stafit aktual të FE të trajnuar

#### Objektiva specifike 1.2. Harmonizimi i metodës së vlerësimit me rezultatet e pritura të nxënit

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.2.1 Aplikimi i ndryshimeve në hartimin e syllabuseve në përputhje me manualin e vlerësimit me rezultatet e pritura të nxënit	FE, PMÇSZHC	Shpenzime administrative	Numri i syllabuseve të ndryshuara	2020 -2021	Syllabuset janë ndryshuar për të reflektuar politikat e reja të njësive

#### Objektiva specifike 1.3 Vendosja e sistemit anti-plagjiat

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.3.1 Trajnimi i stafit për softuere për anti-plagj dhe aplikimi i softuerit	Zyra TI, FE	Shpenzime administrative	Numri i stafit të trajnuar	2020	Stafi i trajnuar dhe 100% e punimeve të studentëve i nënshtrohen sistemit antiplagjiat
1.3.2 Monitorimi i shfrytëzimit të sistemit	FE, Zyra e TI	Shpenzime administrative	Pasqyrimi i të dhënave nga shfrytëzimi i sistemit	2020-2021	Raportet periodike çdo 6 muaj

#### Objektiva specifike 1.4 Aftësimi i vazhdueshëm i stafit

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
1.4.1 Ndjekja e një konference në fushën speciale	FE, PBNKSH Zyra për buxhet dhe	833.00 €	Numri i pjesëmarrjeve	2020-2021	Se paku 70% e stafit kanë ndjekur një

	financa				Konferencë gjatë vitit
<b>1.4.2 Publikimi i se paku nje artikulli ne vit</b>	FE, PBNKSH, Zyra për buxhet dhe financa	833.00 €	<b>Numri i publikimeve</b>	2020-2021	Se paku 70% e stafit kane publikuar nje artikull gjate vitit
<b>1.4.3 Mbeshtetja per kalim nga MA ne PhD</b>	PMÇSZHC,FE, Zyra për buxhet dhe financa	3.333.00 €	<b>Numri i stafit të mbështetur</b>	2020-2021	Mbështetja konkrete e stafit
<b>1.4.4 Aplikimi i stafit per pjesemarrje ne mobilitete</b>	FE, PBNKSH	Fonde të projekteve (Erasmus +,etj)	<b>Numri i aplikimeve të stafit</b>	2020-2021	Se paku 20% e stafit kane aplikuar

#### Objektiva specifike 1.5 Burimet e mësimit dhe mbështetja

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>1.5.1 Shpërndarja e pyetësorëve per vlerësimin e shërbimeve administrative nga stafi akademik.</b>	FE, ZSC	.Shpenzime administrative	<b>Numri i pyetësorëve të plotësuar</b>	2020	Shqyrtimi i rezultateve të pyetësorit
<b>1.5.2 Shpërndarja pyetësoreve për vlerësimin e shërbimeve administrative nga studentet</b>	FE, ZSC	Shpenzime administrative	<b>Numri i pyetësorëve të plotësuar</b>	2020	Shqyrtimi i rezultateve të pyetësorit

#### Objektiva specifike 1.6 Orientimi dhe informimi për të gjitha fazat e ciklit të jetës studentore

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>1.6.1. Hartimi i doracakut për studentë me informatat më relevante që kanë të bëjnë me Fakultetin dhe programin e studimit.</b>	FE, ZSHS	Shpenzime administrative	<b>Doracaku i hartuar ne kuader te FE</b>	2020-2021	Doracaku i publikuar në ueb faqe te FE
<b>1.6.2 Kampanjë informuese për maturantët</b>	ZSHS, FE, Parlamenti studentor	500.00 €	<b>Numri i aktiviteteve të kampanjës</b>	2020-2021	8 aktivitete të realizuara.

#### 1.7. Objektiva specifike: Mbështetja e studentëve

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kosto financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>1.7.1. Mbështetja e studentëve përmes konsultave, tryezave të përbashkëta dhe bashkëpunimit me bizneset-praktikat për studentë.</b>	FE	1.000,00 €	<b>Numri i studentëve pjesëmarrës dhe përfitues nga bashkëpunimi me bizneset.</b>	2019-2021	Tryezat me studente, praktikat nga bashkëpunimi me bizneset.

#### Nën objektiva: Rritja e bashkëpunimit me studentët e diplomuar –Alumni

<b>1.7.2. Anëtarësimi i të diplomuarve në Asociacionin Alumni.</b>	Asociacioni Alumni FE	Shpenzime administrative	<b>Numri i të diplomuarve që anëtarësohen në sociacionin Alumni</b>	2019-2021	100 të antarësuar.
<b>1.7.3. Organizimi i takimit me të diplomuarit në FE dhe Bordit Industrial i FE.</b>	Asociacioni Alumni, FE	500 €	<b>Numri i organizimeve</b>	2020-2021	Eventet e organizuara.
<b>1.7.4. Promovimi i të arriturave të studentëve të FE, storjet e suksesit</b>	Asociacioni Alumni, FE	Shpenzime administrative	<b>Publikimet ne web faqe të FE dhe “Alumni” në rrjete sociale</b>	2020	Faqja e Fakultetit Ekonomik dhe Alumni UMIB.

## Objektiva strategjike: 2. Avansimi i hulumtimit dhe zhvillimit shkencor

### 2.1. Hartimi i planit strategjik të kërkimeve shkencore

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>2.1.1. Publikimet kërkimore shkencore në fushën e ekonomisë me ndikim të rëndësishëm në ekonomi dhe në komunitet</b>	FE, Rektorati	Shpenzime administrative	Numri i punimeve kërkimore shkencore të publikuara	2020 - 2021	Dokumenti i Planit Strategjik për kërkime shkencore i hartuar
<b>2.1.2. Themelimi i institutit të ekonomisë në kuadër të Fakultetit Ekonomik</b>	FE, Rektorati	Shpenzime administrative	Themelimi i institutit në kuadër të Fakultetit Ekonomik	2021	Instituti i themeluar në Fakultetin Ekonomik
<b>2.1.3. Krijimi i grupit kërkimor shkencor në kuadër të Fakultetit Ekonomik</b>	FE, Rektorati	5.00.00	Themelimi i grupit kërkimor shkencor	2021	Grupi kërkimor shkencor i themeluar

### 2.2. Krijimi i fondit nga të hyrat financiare për përkrahje të hulumtimit

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>2.2.1. Aplikimi për përkrahje në skemat e granteve të MASHT – it, dhe me partneritet në projekte të përbashkëta ndërkombëtare</b>	FE, Stafi akademik dhe studentet	Shpenzime administrative	<b>Aplikimet për projekte dhe përkrahje</b>	2020-2021	20% e stafit përfshihen në aplikime

### 2.3. Organizimi i konferencave të FE

2.3.1. Organizimi i një konference shkencore çdo vit në fushën e ekonomisë	Keshilli organizativ	500.00 € Për konferencë	Numri i pjesëmarrësve dhe punimeve shkencore në fushën e ekonomisë	2021	Mbi 30 prezentime brenda dhe jashtëvendit
--	----------------------	----------------------------	--	------	---

### Objektiva strategjike:3. Ndërtimi i sistemit të sigurimit të cilësisë

#### Objektiva specifike 3.1 Zhvillimi i sistemit të sigurimit të cilësisë

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
3.1.1.Ngritja e sistemit për sigurimin e cilësisë përmes angazhimit të trupave të UMIB dhe konsulencës së jashtme	KQSCV-ja; PMÇSZHC;ZSC; Koordinatori i FE	Shpenzime administrative	Udhëzuesi dhe rregullorja për sigurimin e cilësisë e hartuar sipas Statutit të UMIB-it.	2020	Rregullorja dhe udhëzuesi për sigurimin e cilësisë të publikuar në ueb faqe
3.1.2. Vlerësimi dhe mbikëqyrja e sigurimit të cilësisë në mësimdhënie-mësimnxënie	FE, Rektorati i UMIB	Shpenzime administrative	Pyetësor për matjen dhe vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie-mësimnxënie.	2020-2021	Vlerësimi dhe analizimi i rezultateve nga paketa e instrumentëve për matjen e cilësisë në kuader të njesise.
3.1.3. Aplikimi i metodave interaktive dhe bashkëkohore në mësimdhënie	KQSCV-ja; PMÇSZHC; ZSC, FE	Shpenzime administrative	Trajnimi i personelit akademik teknikat dhe qasjet e reja të mësimdhënies.	2020-2021	Zbatimi i njohurive të reja interaktive në procesin e mësimdhënies.
3.1.4. Analiza e tregut për përshtatshmërinë e plan-programeve me nevojat e tregut	ZSC, FE	Shpenzime administrative	Niveli i përshtatshmërisë së programeve të reja me nevojat e tregut	2019-2021	Raporti i hulumtimit mbi analizën e tregut
3.1.5. Aplikimi për specializimet e reja në nivelin Bachelor dhe Master	ZSC; Dekani, Prodekani, Staf akademik, dhe Koordinatori i njësisë akademike	Shpenzime administrative per njesine	Hartimi i RVV dhe përgatitja e forma për aplikim për akreditim në AKA.	2020-2021	Akreditimi i specializimeve të reja në kuadër të programit Menaxhment dhe Biznes.

#### Objektiva specifike 3.2 Avansimi i procesit të brendshëm dhe të jashtëm i matjes së cilësisë

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
3.2.1 Zhvillimi dhe raportimi nga pyetësorët me administratën e FE dhe me stafin akademik;	ZSC, FE	Shpenzime administrative	Numri i pyetësorëve të trajtuar	2019 - 2021	Raporti me gjetjet



3.2.2 Zhvillimi dhe raportimi nga pyetësorët për matjen e cilësisë me studentët: Një në përfundim të çdo semestri.	ZSC, FE	Shpenzime administrative	Numri i pyetësorëve të trajtuar	Pyetësori i parë: Janar 2020; Pyetësori i dytë: qershor 2020. Dhe në selicin vit pasues.	Raporti me gjetjet
3.2.3, Plasimi për plotësim i pyetësorëve për matjen e cilësisë me menaxhmentin e FE	ZSC, FE	Shpenzime administrative	Numri i pyetësorëve të plasuar	Dhejtor 2019- Korrik 2020. Dhe në selicin vit pasues.	Raporti me gjetjet
3.2.4 Plasimi për plotësim i pyetësorëve për matjen e cilësisë me të diplomuarit.	ZSC, FE	Shpenzime administrative për cilësi	Numri i pyetësorëve të plasuar	Dhjetor 2019- Korrik 2020. Dhe në secilin vit pasues.	Raporti me gjetjet
3.2.5 Ri-shikimi dhe plotësimi/përmirësimi i RVV-ve të programeve	ZSC, FE	Shpenzime administrative për cilësi	Numri i RVV te rishikuara	Tetor 2019 dhe proces i vazhdueshëm	RVV-të e ri-shikuara
3.2.7 Ri-shikimi i planeve mësimore dhe programeve të aplikueshme	ZSC, FE	Shpenzime administrative për cilësi	Numri i planeve mësimore të rishikuara	Tetor 2019 dhe proces i vazhdueshëm	Planet e ri-shikuara

### Objektiva specifike 3.3 Trajnimi i stafit akademik

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
3.3.1 Vijimi i trajnimeve të organizuara nga UMIB për stafi akademik	PMCS, ZSC, FE	300.00 €.	Numri i mësimdhënësve të trajnuar	2020-2021	Certifikimi i mësimdhënësve

### Objektiva specifike 3.4 Ngritja e kulturës së cilësisë

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
3.4.1 Informimi dhe konsultimi për rëndësinë e sigurimit të cilësisë përmes punëtorive për stafin dhe studentë	ZSC dhe FE	Shpenzime administrative	Aktivitetet e organizuara	2020-2021	Numri i i punëtorive të organizuara

## Objektiva strategjike: 4. Zhvillimi i burimeve njerëzore, digjitalizimi dhe informimi publik

### 4.1. Plani i burimeve njerëzore për personelin akademik

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>4.1.1. Përpilimi i Planit vjetor për avancime akademike dhe rekrutimi i personelit akademik për specializime të reja.</b>	FE, Menaxhmenti, ZÇA – ZP)	Shpenzime administrative	<b>Avancime meritore dhe identifikimi i personelit akademik kompetent</b>	2020-2021	Plani i personelit për avancime dhe për rekrutim i hartuar në detaje.
<b>4.1.2. Zhvillimi procesit të plotësimit të vendeve të lira bazuar në planin e personelit dhe mjetet buxhetore</b>	FE (Menaxhmenti – ZÇA – ZP)	19.000, 00 €	<b>Konkursi i realizuar dhe procedurat e rekrutimit</b>	2020-2021	Plotësimi i vendeve të lira të punës sipas planit të hartuar.
<b>4.1.3. Zhvillimi i planit për trajnim të personelit akademik.</b>	Këshilli i FE, Dekani dhe Prodekani	Shpenzime administrative	<b>Organizimi sipas planit vjetor për trajnime për PA</b>	2020-2021	Plani vjetor i trajnimit të personelit akademik i hartuar.
<b>4.2. Zhvillimi dhe avancimi i (Personelit akademik) të burimeve njerëzore</b>					
<b>4.2.1. Zhvillimi i procedurave për avancimin e personelit akademik</b>	Rektorati, Këshilli Drejtues/Senati, Këshilli i Studimeve, Këshilli i FE	Shpenzime administrative	<b>Avancimi i tre profesorëve nga “Prof.ass në Prof.asoc” si dhe dy “Asistent Ligjerues në Prof.ass”.</b>	2021	Sipas rregullorës për avancimin e stafit akademik.
<b>4.3. Përditësimi i infrastrukturës sipas teknologjisë më të avansuar</b>					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>4.3.1. Pajisja e sallave mësimore dhe zyreve me pajisjet të avansuara harduerike dhe softuerike.</b>	Rektorati, IT, Zyra e financave Menaxhmenti i FE	6.000,00	<b>Sallat mësimore dhe zyret të pajisura me teknologji te avancuar</b>	2020-2021	Proces mësimor me aplikimin e metodave të avansuara të mësimdhënies.

<b>4.3.2. Pajisja e kabineteve me pajisjet të avansuara harduerike dhe softuerike.</b>	Rektorati, TI, Zyra e financave, Menaxhmenti i FE	4.000,00	<b>Kabinetet e pajisura me teknologji te avancuar</b>	2020-2021	Punë praktike me aplikimin e teknologjise se avancuar sipas standardeve bashkëkohore të studimeve
<b>4.3.3. Furnizimi i bibliotekës me pajisje të avansuara harduerike dhe softuerike si dhe biblioteka digjitale.</b>	Rektorati, TI, Zyra e auditimit, FE, Zyra e financave	1.333..00	<b>Biblioteka e pajisur me teknologjinë e re</b>	2020-2021	Mësim në bibliotekë të pajisur me kompjuter, internet dhe çasje në biblioteka digjitale.

#### 4.4. Objektiva specifike: Digjitalizimi i procesit të evidentimit dhe kontrollit të vijueshmërisë së stafit akademik/administrativ dhe studentëve

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kosto financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>4.4.1. Digjitalizimi i evidentimit dhe kontrollit të vijueshmërisë së stafit akademik/administrativ.</b>	Menaxhmenti, IT, PMÇSZHC, Sekretari, FE	1.333.00 €	<b>Integrimi i shërbimit të evidentimit të vijueshmërisë për stafin akademik/administrative në FE</b>	2020-2021	Evidentim më eficient i prezencës së stafit dhe lehtësimi i kontrollit dhe raportimit. Ngritja e nivelit të respektimit të orarit të punës për 10%
<b>4.4.2. Digjitalizimi i evidentimit dhe kontrollit të vijueshmërisë së studentëve.</b>	PMÇSZHC, IT, ZSHS, FE	850,00 €	<b>Integrimi i shërbimit të evidentimit të vijueshmërisë për studentë në sallat dhe kabinetin e TI të FE</b>	2020-2021	Evidentim më eficient i prezencës së studentëve Ngritja e nivelit të respektimit të orarit të ligjeratave dhe ushtrimeve për 10%

#### 4.5. Objektiva specifike: Informimi dhe komunikimi me publikun

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kosto financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>4.5.1. Përditësimi i informatave në web faqe për ngjarjet në FE</b>	Menaxhmenti i FE, ZIKP	Shpenzime administrative	<b>Lajmet/njoftimet e publikuara në web faqe të UMIB-it, për aktivitetet e Fakultetit Ekonomik.</b>	2019-2021	Rritja e transparencës, Depërtimi i informatave për Fakultetin Ekonomik në publik.
<b>4.5.2. Promovimi i FE përmes materialeve promovuese dhe mjeteve tjera alternative</b>	Rektorati, Menaxhmenti i FE	900.00 €	<b>Broshura promovuese, fletore, kalendarë, stilolapsa...</b>	2020/2021	Rritja e prestigjit të FE.

#### Objektiva strategjike: 5. Bashkpunimi ndërinstitucional e ndërkombetar

<b>5.1. Krijimi i bazës legale, funksionalizimi i zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar dhe hartimi i strategjisë për ndërkombëtarizim</b>					
<b>Aktivitetet</b>	<b>Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse</b>	<b>Kostoja financiare(E UR)</b>	<b>Treguesi kryesor i performancës</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Rezultati i pritur i performancës</b>
<b>5.1.1 Krijimi i Bordit industrial te FE</b>	FE, Rektorati	Shpenzime Administrative	<b>Takimet, rekomandimet</b>	2020	Bordi Industrial i krijuar
<b>5.2. Ngritja e nivelit të partneritetit dhe marrëveshjeve biznesore</b>					
<b>Aktivitetet</b>	<b>Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse</b>	<b>Kostoja financiare(E UR)</b>	<b>Treguesi kryesor i performancës</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Rezultati i pritur i performancës</b>
<b>Aktivitetet</b>	<b>Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse</b>	<b>Kostoja financiare(E UR)</b>	<b>Treguesi kryesor i performancës</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Rezultati i pritur i performancës</b>
<b>5.1.1 Procesi i themelimit të Bordit industrial në FE</b>	FE, Rektorati	Shpenzime Administrative	<b>Numri i takimeve me palët e interesit</b>	2020	Bordi Industrial i krijuar
<b>5.2.2. Përkrahja e stafit për pjesëmarrje në Konferenca shkencore</b>	PBNKSH, ZBN, FE, Zyra për buxhet dhe financa	3.333.00 €	<b>Numri i stafit të rregullt akademik i përkrahur për pjesëmarrje në konferenca/vit.</b>	2020-2021	Pjesëmarrja ne Konferenca nderkombetare. Ngritja e numrit të personelit akademik që shërben nëpër borde editoriale të revistave / konferenca shkencore ndërkombëtare .
<b>5.3. Rritja e aplikimeve në projekte të përbashkëta për fonde ndërkombëtare</b>					
<b>Aktivitetet</b>	<b>Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse</b>	<b>Kostoja financiare(E UR)</b>	<b>Treguesi kryesor i performancës</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Rezultati i pritur i performancës</b>
<b>5.3.1.Pjesëmarrja në trajnim e personelit akademik/administrativ në ngritjen e kapaciteteve profesionale për aplikim në projekte dhe thithjen e fondeve ndërkombëtare</b>	PBNKSH, ZBN dhe FE	Shpenzime administrative	<b>Numri i punëtorive të vijura për ngritjen e kapaciteteve për aplikime në projekte</b>	2020-2021	Vijimi i një punëtorie në vit nga përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ të FE

<b>5.3.2. Aplikimi në projekte e mobiliteti për staf dhe studentë</b>	PBNKSH, ZBN, FE, Staf i akademik dhe administrativ dhe studentët	Shpenzime administrative	<b>Numri i aplikimeve ne projekte mobiliteti</b>	2020/2021	Aplikimi i FE me një projekt
---	--	--------------------------	--	-----------	------------------------------

#### **5.4. Rritja e mobilitetit të personelit dhe studentëve (Internship, vazhdim studimesh etj.)**

<b>Aktivitetet</b>	<b>Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse</b>	<b>Kostoja financiare(E UR)</b>	<b>Treguesi kryesor i performancës</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Rezultati i pritur i performancës</b>
<b>5.4.1.Pjesëmarrja në punëtori për personelin akademik/administrativ dhe studentët në ngritje e kapaciteteve profesionale për aplikim për mobilitet ndërkombëtar</b>	PBNKSH, ZBN, FE, Staf i akademik dhe administrativ dhe studentët	Shpenzime administrative	<b>Numri i punëtorive të mbajtura për ngritjen e kapaciteteve për aplikime për mobilitet</b>	2020/2021	Vijimi i një punëtorie në vit nga përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ të FE

#### **5.5. Skemat programore/bursa për studentë**

<b>Aktivitetet</b>	<b>Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse</b>	<b>Kostoja financiare(E UR)</b>	<b>Treguesi kryesor i performancës</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Rezultati i pritur i performancës</b>
<b>5.5.1. Ngritja e kapaciteteve të stafit akademik dhe studenteve rreth procedurave të aplikimit</b>	PBNKSH, ZBN, FE	Shpenzime administrative	<b>Numri i punëtorive të vijuar për ngritjen e kapaciteteve për bursa në skema të ndryshme programore</b>	2020-2021	Vijueshmëria e një punëtorie në vit për përfaqësues të stafit akademik dhe studentëve të FE

#### **5.6. Menaxhimi i të dhënave për projekte dhe donacione ndërkombëtare**

<b>Aktivitetet</b>	<b>Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse</b>	<b>Kostoja financiare(E UR)</b>	<b>Treguesi kryesor i performancës</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Rezultati i pritur i performancës</b>
<b>5.6.1. Monitorimi dhe raportimi për projektet e përfituara dhe të realizuara</b>	FE, PBNKSH, ZBN	Shpenzime administrative	<b>Përpilimi i planit për monitorimin e kualitetit</b>	2020-2021	Raportime tremujore
<b>5.6.2. Përmirsimi i burimeve dhe infrastrukturës për të mbështetur bashkëpunim ndërkombëtar</b>	FE, PBNKSH, ZBN, TI	Shpenzime administrative	<b>Krijimi i aksesit online për stafin akademik dhe për student për t'u njohur me të arritjet e reja në fushën e ekonomisë përmes rrjetit digjital</b>	2020-2021	<b>Burimet dhe infrastruktura e përmirësuar për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e ekonomisë</b>

#### **5.7. Bashkëpunimi institucional alumni /industri/institucione lokale dhe në nivel qendror**

Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>5.8.1. Organizimi i eventeve të përbashkëta lidhur me ngjarjet në njësi akademike dhe UMIB me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit mes Alumnit, Bordit Industrial dhe përfaqësuesve të industrisë</b>	FE, së bashku me akteret relevant në kuader të UMIB-it.	166.00 €	<b>Ftuarja e Alumnit, Bordit Industrial dhe përfaqësuesve të industrisë ne ngjarjet e Universitetit/Fakultetit Ekonomik</b>	2020 – 2021	Organizimi një eventi nga Fakulteti Ekonomik
<b>5.8. Objektiva specifike: Lidhja e Alumni me industrinë dhe punëdhënësit qeveritar</b>					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare(E UR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
<b>5.8.1. Krijimi i sistemit të të dhënave të punëdhënësve për studentët</b>	FE	Shpenzime administrative	<b>Krijimi i databazës së punëdhënësve dhe komunikimi</b>	2020 - 2021	Databaza me listën e punëdhënësve potencial për punësim dhe praktikë të studentëve

## MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe vlerësimi janë faktorë themelorë të zbatimit të një strategjie të mirëfilltë dhe synojnë matjen e progresit të arritur.

Në kuadër të FE, është krijuar grupi për kordinim dhe monitorim të zbatimit të PSFE, i cili udhëhiqet nga një Kordinator i emëruar në Këshill të FE.

Detyrat kryesore të këtij grupi, janë:

- Hartimi i planeve të arriturave 6 mujore të veprimit në përputhje me PSFE
- Analiza e progresit në zbatimin e PSFE, në bazë të informatave të mbledhura
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave plotësuese për të siguruar zbatimin e PSFE
- Raportimi në Këshillin e FE .

Këshilli i FE do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të këtij Plani Strategjik. Grupi për Kordinimin dhe Monitorimin do të përpilojë raportet e performancës të

zbatimit të PSFE dhe do të raportoj tek Këshilli i FE dhe këto të dhëna do të shqyrtohen nga ana e këtij Këshilli . Këta tregues do të mundësojnë monitorimin e progresit duke vënë në dukje nivelin e arritjes së objektivave dhe realizimin e aktiviteteve strategjike. Monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm i kësaj strategjie mundëson jetësimin e planit të veprimit dhe u siguron zbatuesve të saj një pasqyrë e cila ua mundëson të veprojnë me kohë dhe në përputhje me nevojat dhe sfidat me të cilat përballen. Në fund të zbatimit të strategjisë do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm për të kontrolluar deri në çfarë mase kjo strategji ka ndikuar në forcimin e njësisë sone, në mënyrë që rezultatet, vështirësitë, ndikimi, qëndrueshmëria, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet të shërbejnë për strategjitë në të ardhmen.

Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi gjithëpërfshirës, FE do të jetë në gjendje t'i planifikoj strategjitë e ardhshme. Veprimet dhe aktivitetet që do të ndërmerren për implementimin e këtij dokumenti do të mundësojnë vazhdimin e zhvillimit të FE, si një institucion me rëndësi, për mësimdhënie të avancuar, edukim cilësor, por edhe për punë hulumtuese e shkencore, në nivel vendi dhe më gjërë.

## **PËRFUNDIM**

Plani strategjik i institucionit tonë me rëndësi të madhe për mbarëvajtjen e punëve në institucionin tonë, pasi që shërben si një udhërefyës mbi atë se nga do të lëvizim ne si institucion i Arsimit të Lartë në mënyrë që të mund të jemi gjithnjë në hap me trendet e zhvillimit ekonomik.

PSFE, do të ndihmojë në vazhdimin e mëtejshëm drejt ngritjes së cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe zhvillimin e programeve mësimore në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Prandaj, implementimi i këtij Plani Strategjik shtrohet si një obligim për të gjithë akterët e FE, për të punuar në përmbushjen dhe avancimin e misionit të fakultetit, si dhe obligimeve që FE ka ndaj studentëve dhe qytetarëve të Kosovës për një arsim cilësor dhe me vlera. Nga data e miratimit të këtij dokumenti të gjitha aktivitetet zhvillimore të FE, do të udhëhiqen nga ky dokument, i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së strukturës menaxhuese dhe tërë stafit akademik të fakultetit.